



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/31
Datë: 20.02.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në pajtim me nenin 56, paragrafi 5. të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 shkurt 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Tërhiqet nga shqyrtimi në Kuvend Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi për të bërë plotësimin dhe ndryshimin e këtij Projektligji duke reflektuar rrethanat e reja, përkatësisht Aneks Marrëveshjen e nënshkruar me datë 16.02.2018 ndërmjet Presidentit të Republikës së Kosovës, Sh.T.Z. Hashim Thaçi dhe Presidentit të Malit të Zi, Sh.T.Z. Filip Vujanović, për rishikimin dhe korrektimin e sektorëve në drejtim të Çakorrit dhe Kullës së Zhlepit.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Ramush HARADINAJ
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë